

THIRRJE PËR APLIKIME - Pronar social

04.01.2024

Në zbatim të nenit 23, pika 2 të ligjit nr. 22.2018 “Për strehimin social” , Bashkia Gjirokastrer shpall Thirrjen për Aplikime për të gjitha subjektet publike dhe private të cilët janë të interesuar për të për fituar statusin “Pronar social” .

“**Pronar social**” është çdo subjekt publik, përveç njësisë të vetëqeverisjes vendore, si dhe çdo subjekt privat, që investon në banesa sociale me qira ose që disponon banesa për t`i dhënë me qira për familjet në nevojë për strehim.

Pronari Social mbështetet nëpërmjet financimeve për subvencionimin e qirasë për familjet përfituese të miratuar nga këshilli bashkiak.

Çdo subjekt publik apo privat që disponon banesa për t`i dhënë me qira për familjet në nevojë për strehim, mund të aplikojë pranë bashkisë për t`u regjistruar si “Pronar Social” nëse plotëson kriteret e mëposhtme:

1. Banesa plotëson kushtet teknike dhe normat e strehimit në fuqi, referuar raportit të strukturës përgjegjës në bashki;
2. Qiraja e banesës nuk është më e lartë se qiraja mesatare në tregun e lirë;
3. Nënshkrimi i një deklarate që nuk do të refuzojë qiramarrës për arsye që përbëjnë diskriminim;
4. Nënshkrimi i një marrëveshje ndërmjet pronarit social dhe bashkisë që parashikon:
 - afatin e marrëveshjes që nuk mund të jetë më pak se 3 vjet;
 - masën e qirasë mujore dhe mënyrën e shlyerjes së saj;
 - mënyrën e administrimit të pronës dhe të marrëdhënieve me qiramarrësin.

Dokumentacioni i nevojshëm:

1. Deklaratë për shprehje interesi për të aplikuar si “pronar social”;
2. Shprehje e dakordësisë që nuk do të refuzojë qiramarrës për arsye diskriminuese;
3. Vërtetim pronësie mbi banesën/banesat në pronësi që jepen me qira për familjet në nevojë për strehim;
4. Ekstrakt të QKR-së, QKB-së për personat fizik/juridik;
5. Fotokopje të kartës së ID;
6. Saktësim adrese.

Afati i aplikimeve është deri me **05. 02.2024**.